



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë punësojë **1 (një) specialist në sektorin e IT dhe komunikimit, në Drejtorinë e IT dhe Inxhinierisë Klinike, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsimit i Lartë, profili Inxhinieri Elektronike/ Informatike dhe degët e lidhura me teknologjinë e informacionit. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Preferohet të ketë eksperiencë pune;
- Njohuri të gjëra mbi teknologjinë e informacionit
- Njohuri shumë të mira të programeve kompjuterike, rrjetet kompjuterike si dhe sistemeve të sigurisë
- I aftë të ofrojë mendime teknike të vlefshme për fushën që mbulon.
- Të njoh shumë mirë procedurat administrative;
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Të ketë përkushtim maksimal gjatë orarit të punës.
- Aftësi shumë të mira komunikimi.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentata në gjuhën shqipe si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV) (në gjuhën shqipe)
3. Diplomën/at e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (link <http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU “Nënë Tereza” duke nisur nga data **01.11.2021 ora 08:00** deri më **15.11.2021 ora 16:30**.

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE